



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



[www.komuna-kline.org](http://www.komuna-kline.org)

*Kuvendi i Komunës Klinë*

*Komiteti për Politikë dhe Financa*

01Nr 06-34145 /25

Klinë, dt: 09.10 /25

## PROCESVERBAL

**Nga mbledhja e nëntë e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 09.09.2025, me fillim nga ora 09:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.**

Mbledhjen e hapi Kryesuesi, z. Fadil Gashi, i cili përshëndeti drejtorët, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe OSBE-në.

**Kryesuesi prezantoi rendin e ditës:**

1. Arsyetimi i mungesave;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi i draft-buxhetit për vitin 2026 (ref.drejt.Fin);
4. Shqyrtimi i propozimit për shtim buxheti për projektin “Ndërtimi i serrave për fermerë përfitues individual” (ref.drejt.Bujqësisë);
5. Shqyrtimi i Planit ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave (ref.DSHPE);
6. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajt gusht-shtator 2025;
7. Të ndryshme.

**Fadil Gashi, kryesues:** Mirë se erdhët në Komitetin për Politikë dhe Financa. Unë ju përshëndes si anëtarë, po ashtu përshëndes drejtorin e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, OSBE-në që është bashkë me ne, dhe Ahmetin. Me lejoni të hap mbledhjen, duke besuar se e keni marrë rendin e

ditës bashkë me materialin. Nëse ka dikush për rend të ditës, po hap debat, duke ju konfirmuar se Blerina mori leje sepse ka një rast, ndërsa Tuna është në rrugë dhe do të na bashkohet. Përndryshe, ne jemi shumicë dhe do të vazhdojmë me mbledhjen. A ka dikush për rend të ditës? Nëse nuk ka, kush është për?

**Me 5 vota PËR, u miratua rendi i ditës.**

**Pika 1. Arsyetimi i mungesave.**

**Fadil Gashi, kryesues:** Tek arsyetimi i mungesave, sapo ju njoftova për Blerinën dhe Tunën.

**2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**

**Fadil Gashi, kryesues:** A ka dikush për procesverbal?

**Me 5 vota PËR, u miratua procesverbali nga mbledhja e kaluar.**

**3. Shqyrtimi i draft-buxhetit për vitin 2026 (ref.drejt.Fin).**

**Fadil Gashi, kryesues:** Ju e dini që tashmë keni afatet, si ligjore, ashtu edhe procedurale. Jemi në kohën e hartimit dhe miratimit të buxhetit. Ne e kemi këtu drejtorin, nëse dëshironi një prezantim, nëse jo, ju materialin e keni. A ka dikush për buxhetin?

**Pas shqyrtimit të draft-buxhetit për vitin 2026 dhe projeksioneve për vitet 2027-2028, Komiteti për Politikë dhe Financa, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, me 5 vota PËR, rekomandoi që draft-buxheti për vitin 2026 të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.**

**Pika 4. Shqyrtimi i propozimit për shtim buxheti për projektin “Ndërtimi i serrave për fermerë përfitues individual” (ref.drejt.Bujqësisë).**

Kërkesë e parashtruar nga Drejtoria për Financa, duke u bazuar në kërkesën e Drejtorisë së Bujqësisë, me anë të së cilës kërkohet që të merret vendim për shtim të buxhetit për projektin “Ndërtimi i serrave për fermerë përfitues individualë” nga participimi i qytetarëve, në shumën prej 13,470.00 euro.

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga Drejtoria**

për Financa, me 5 vota PËR, rekomandoi që kërkesa të dërgohet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

**Pika 5. Shqyrtimi i Planit ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave (ref.DSHPE).**

Kërkesë e parashtruar nga Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë, për shqyrtimin dhe aprovimin e planit ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave.

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të planit ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave, me 5 vota PËR, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, rekomandoi që i njëjti të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.**

**Pika 6. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajt gusht-shtator 2025.**

#### **Kërkesa 1.**

Kërkesë e parashtruar nga z. Pren Cubi për këmbimin e pronës së paluajtshme private, parcela me nr. 00505-13, në sipërfaqe prej 1376 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale Drenoc, që të këmbëhet me pronë komunale: parcela me nr. 00261-0, në sipërfaqe prej 464 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale Drenoc, dhe pjesën e parcelës me nr. 00262-0, me sipërfaqe prej 812 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale Drenoc.

**Fadil Gashi, kryesues:** Është punë që është kryer me dekret të presidentes. Nuk mund ta shfrytëzojmë për dhënie në shfrytëzim të pronave, as për ndërrim të pronave. Do të thotë që përgjigja i kthehet palëve, sepse jemi të kufizuar tashmë në marrjen e vendimeve të kësaj natyre. A jeni pajtuar? Kush është për?

**Komiteti për Politikë dhe Financa njofton z. Pren Cubi se ka shqyrtuar kërkesën duke analizuar të gjitha mundësitë për t'i ofruar një zgjidhje. Megjithatë, për shkak të kufizimeve të parashikuara me Ligjin Nr. 06/L-092 "Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës", konkretisht Nenin 10 të këtij Ligji ("Kufizimet e komunës"), është e pamundur të gjendet një zgjidhje në këtë fazë. Sipas këtij neni, Kuvendi i Komunës dhe organet ekzekutive të saj nuk mund të marrin asnjë vendim lidhur me dhënien në shfrytëzim ose këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës nga dita e shpalljes së zgjedhjeve lokale nga Presidenti/ja i Republikës.**

#### **Kërkesa 2.**

Kërkesë e parashtruar nga znj. Nazife Gucati, me anë të së cilës kërkon mbështetje financiare, pasi që, sipas deklarimit, jeton në kushte të vështira ekonomike, nuk posedon shtëpi apo banesë, por jeton me qira me dy fëmijët e saj dhe është tepër e vështirë t'ia dalë e vetme.

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga znj. Nazife Gucati, me 5 vota PËR, rekomandoi që kërkesa të dërgohet për shqyrtim në Kuvend dhe të shikohet mundësia që t'i ndahet një shumë nga ana e Kuvendit për mbulimin e qirasë së banimit.**

**Pika 7. Të ndryshme.**

**Fadil Gashi, kryesues:** Në të ndryshme, a ka dikush? Po, Asdren.

**Asdren Ramadani:** Faleminderit, kryesues! Desha prapë të ngre një shqetësim, se te rruga e gjimnazit janë të thyera 4-5 kapakë të kanalizimit dhe askush nuk po merret me ta.

**Fadil Gashi, kryesues:** Ne këtu nuk merremi me ta, por do të bëjmë një rekomandim për drejtorinë e Urbanizmit që të na japë një përgjigje në seancë. Dikush tjetër? Nëse nuk ka, unë sinqerisht ju falënderoj, duke besuar dhe shpresuar se ky është komiteti i fundit që e mbajmë, përveç nëse ka ndonjë rast urgjent ose ndonjë gjendje të jashtëzakonshme. Unë sinqerisht ju falënderoj për gjithë bashkëpunimin që kemi pasur. Kujtoj që kemi pasur një bashkëpunim jashtëzakonisht korrekt dhe të sinqertë mes veti si KPF, dhe ju uroj gjithë të mirat juve që jeni në garë tani. Ruani qetësinë, ruajuni prej urrejtjeve dhe fjalëve që nuk ju takojnë, dhe zhvilloni fushatën pa kompromis. Faleminderit shumë!

**Procesmbajtësja:**  
**Monika Palushi**

*Monika Palushi*



**KRYESUESI:**  
**Fadil Gashi**

*Fadil Gashi*